



**FORMULAR VETËDEKLARIMI**

**PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"**

**DATË: 29/ 04/2016**

**I. TË DHËNAT PERSONALE**

**A. Gjeneralitetet aktuale**

EMËR	Petrit
MBIEMËR	Vukaj
ATËSI	Gjelosh
AMËSI	Zoje
DATËLINDJE	15.09.1966
VENDLINDJE	Tropoje
VENDBANIM	Fier
NR. ID	G60915080J

**B. Gjeneralitete të mëparshme**

(Nëse keni ndryshuar zyrtarisht ndonjë nga të dhënat e gjeneralitetit tuaj, apo keni përdorur një gjeneralitet tjetër, qoftë edhe pa e ndryshuar zyrtarisht, listoni secilin prej tyre, duke plotësuar të gjitha të dhënat që janë ndryshuar dhe aq herë sa janë ndryshuar. Mosdeklarimi i ndonjë gjeneraliteti sipas kësaj pike, që mund të pengojë verifikimin sipas dispozitave të ligjit nr. 138/2015, përbën vepër penale sipas nenit 190 të Kodit Penal.)

EMËR	
MBIEMËR	
ATËSI	
AMËSI	
DATËLINDJE	
VENDLINDJE	

*Petrit Vukaj*  
(emër, mbiemër, nënshkrim)


## II. MARRJE DIJENI MBI EFEKTET E FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT

Unë, i/e nënshkruari /a Petrit Vukaj , kam marrë dijeni dhe jam i vetëdijshëm se:

- a) Ky Formular përbën dokument zyrtar që i drejtohet një organi shtetëror dhe i nënshtrohet verifikimit dhe publikimit.
- b) Pasqyrimi i të dhënave të rreme në këtë Formular përbën vepër penale dhe dënohet me burgim sipas nenit 190 të Kodit Penal.
- c) Të dhënat e pasqyruara në këtë Formular i nënshtrohen verifikimit të plotë, brenda dhe jashtë Shqipërisë, nga organet shtetërore dhe Prokuroria e Përgjithshme.
- ç) Me plotësimin e këtij Formulari, kam dhënë pëlqimin për verifikimin e çdo të dhëne personale, përfshirë gjurmët daktiloskopike dhe çdo të dhënë tjetër biometrike.
- d) Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë Formular dhe refuzimi i depozitimit të gjurmëve daktiloskopike, passjell skualifikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i mëtejshëm i funksionit publik.
- e) Trajtimi i të dhënave do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke qenë i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara në këtë Formular.

**KUJDES: JENI I/E SIGURT? SUGJEROHET QË NËNSHKRIMI I KËTIJ SEKSIONI TË BËHET PASI ËSHTË PLOTËSUAR SAKTË I GJITHË FORMULARI!**

  
(emër, mbiemër, nënshkrim)

  
(emër, mbiemër, nënshkrim)

### III. TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT

1. A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj? (Vendos X përbri përgjigjes)

PO  JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Të dhënat e vendimit gjyqësor				
Gjykata	Nr. dhe data e vendimit gjyqësor të formës së prerë	Masa e dënimit me burgim	Vepra penale për të cilën jeni dënuar	
			Neni	Lloji

2. A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë? (Vendos X përbri përgjigjes)

PO  JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Të dhënat e vendimit gjyqësor				
Të dhënat e vendimit gjyqësor jopërfundimtar	Gjykata	Vepra penale për të cilën jeni dënuar		Vendimi përfundimtar/Dënimi
		Neni	Lloji	

*Rehit Vukaj*  
(emër, mbiemër, nënshkrim)

3. **A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale? (Vendos X përbri përgjigjes)**

PO

JO

- Nëse po, specifíkoni të dhënat e mëposhtme:

Organi procedues	Qyteti, Shteti	Arsyet	Periudha/Data	Rezultatet

4. **A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale? (Vendos X përbri përgjigjes)**

PO

JO

- Nëse po, specifíkoni të dhënat e mëposhtme:

Organi procedues	Qyteti, Shteti	Arsyet	Periudha/Data	Rezultatet
Hetuesia , Fier	Fier, Shqiperi	I dyshuar per vjedhje	2 (Dy) dite ne Mars te vitit 1992	Pushuar ,pezulluar per zbulim autori.

5. **A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo? (Vendos X përbri përgjigjes)**

PO

JO

- Nëse po, specifíkoni të dhënat e mëposhtme:

*Petrit Nuka jchy*  
(emër, mbiemër, nënshkrim)

MASAT SHTRËNGUESE TË SIGURISË	PËRGJIGJE	
	Aktualisht në fuqi	E revokuar
Ndalimi i daljes jashtë shtetit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Ndalimi dhe detyrimi i qëndrimit në një vend të caktuar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Garancia pasurore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Arrestimi në shtëpi	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Arrestimi në burg	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Gjykata	Qyteti, shteti	Vepra penale për të cilën akuzoheshit		Vendimi përfundimtar	Periudha, data
		Neni	Lloji		
Gj. Shkalles Se Pare per Krimet e Renda	Tirane, Shqiperi	319 germa ç, i K.P	Arrest ne burg	Jo	28.11.2015 - 12.12.2015
Gj.Apelit Per Krimet e Renda	Tirane, Shqiperi	319 germa ç, i K.P	Arrest ne shtepi	Po	12.12.2015 – ne vazhdim

6. **A është lëshuar ndonjëherë ndaj personit tuaj një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale? (Vendos X përbri përgjigjes)**

PO

JO

Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Autoriteti urdhërues	Arsyeja	Qyteti, Shteti	Ekzekutimi (nëse është në fuqi apo jo)

7. **A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?**

*(Me përjashtim të rastit kur jeni dëbuar ekskluzivisht për shkeljen e rregullave të emigracionit që kanë të bëjnë me rregullat e qëndrimit apo hyrje-daljes në një territor të një shteti të huaj) (Vendos X përbri përgjigjes)*

PO

JO

*Petrit Vukaj*  
(emër, mbiemër, nënshkrim)

- Nëse po, specifíkoni të dhënat e mëposhtme:

Qyteti dhe Shteti ku keni jetuar	Arsyeja dëbimit	Periudha e dëbimit nga shteti i huaj	Të dhanat e aktit të dëbimit

**8. A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj? (Vendos X përbri përgjigjes)**

PO

JO

- Nëse po, specifíkoni të dhënat e mëposhtme:

Qyteti dhe Shteti ku keni jetuar	Arsyeja	Periudha	Adresa e vendqendrimit

Duke qenë i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara në këtë Formular.

Petrit Nukaj  
(emër, mbiemër, nënshkrim)

**Shënim:** Në rast referimi të akteve, vendimeve dhe dokumenteve të caktuara, bashkëngjitini një kopje të tyre këtij Formulari.

Nëse pjesë të caktuara të Formularit janë të pamjaftueshme për deklarimin e të dhënave, shto atë pjesë sa ju nevojiten për pasqyrimin e të gjitha të dhënave.

Petrit Nukaj  
(emër, mbiemër, nënshkrim)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË  
PËR KRIME TË RËNDA  
TIRANË



NR .498 Akti

NR.498 VENDIMI

VENDIM

**“PËR CAKTIMIN E MASËS SË SIGURIMIT”**

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga:

**Gjyqtar: BIB NDRECA**


asistuar nga sekretare gjyqësore Andina Kaja, në Tiranë sot më datë 26.11.2015, ora 15:00, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura kërkesën penale me Nr. 498 akti me:

**KËRKUES:** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar nga prokurorja Enkeleda Millonai.

**PERSONI NËN HETIM:** Petrit Vukaj, i biri i Gjelosh dhe i Zojë, i datëlindjes 15.09.1966, lindur në Shëngjergj Tropojë, banues në Fier, i martuar, me profesion jurist, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

**OBJEKTI :** Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues, “arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim Petrit Vukaj.

**BAZA LIGJORE** Nenet 228, 229, 230, 232/dh, 238, 244, 245, të K.Pr.Penale.



ngarkim të tij, duke kërkuar madje edhe lirimi i menjëhershëm i tij. Kështu për këtë shkak, ai ka kontaktuar disa herë me vëllain e tij Arjan Xhemalin, dhe ky i fundit me shtetasin Gazmir Nelollari, me detyrë punonjës policie.

Nga ana e policisë gjyqësore, janë kryer një sërë veprimesh hetimore në drejtim të zbardhjes së kësaj ngjarjeje, ndër të tjera duke mbajtur nën vëzhgim personat e dyshuar si autorë të mundshëm. Kështu ka rezultuar, se Arjan Xhemali, ishte personi që krijonte kontakte të drejtëpërdrejta fizike apo telefonike, me persona të ndryshëm, për llogari të Elton Xhemalit (vëllait të tij), me qëllim lirimin e tij nga burgu, kundrejt veprimeve korruptive.

Nga këto veprime hetimore, rezulton se personi kontakti ishte shtetasi Gazmir Nelollari, ku ky i fundit, vërehet se ishte personi që kishte mundësi të takohej drejtëpërdrejtë me funksionarë të drejtësisë, dhe konkretisht me prokurorin e çeshtjes në ngarkim të vëllait të tij. Takimi fillimisht ndërmjet Arjan Xhemalit dhe Prokurorit, ka qenë pasi prokurori i ka kërkuar atij lejen e drejtimit të automjetit dhe disa dokumenta për rrethanat familjare për vëllain (për shtetasin Elton Xhemali), që ishte përfshirë në aksident.


Ndërsa takimi tjetër ndërmjet Arjan Xhemalit, prokurorit **Petrit Vukaj**, dhe Gazmir Nelollari, është realizuar në një lokal në afërsi të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku kanë pirë kafe dhe kanë shkëmbyer numrat e telefonit njëri me tjetrin.

Shtetasi Gazmir Nelollari, përshkak edhe të funksionit që kishte, (punonjës policie), i ka thënë shtetasit Arjan Xhemali, se do të takohej në vazhdim me prokurorin e çeshtjes, në mënyrë që të bënin të mundur nxirrjen e Elton Xhemalit me arrest shtëpie (kjo sipas deklarimeve të bëra nga Arjan Xhemali i pyetur me cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, dhe deklaratimet e dhëna në seancën gjyqësore të verifikimit të kushteve të masës së sigurimit të datës 10.11.2015).

Por shtetasit Gazmir Nelollari, ka vënë në dijeni Arjan Xhemalin, se për nxirrjen e Elton Xhemalit me arrest shtëpie do të duheshin ti jepeshin disa lekë prokurorit, rreth dy milion deri në tre milion lekë (të vjetra). Në këto kushte, Arjan Xhemali sipas porosisë së Gazmir Nelollarit, ka gjetur tek të afërmit e tij paratë në shumën prej dy milion e gjysëm lekë (të vjetra), dhe ja ka dhënë njëdërmjetësit Gazmir Nelollari.

Pasi Gazmir Nelollari ka marrë paratë, i ka premtuar Arjan Xhemalit (sipas deklarimeve të këtij të fundit), se ato do t'i jepeshin prokurorit Petrit





Nga veprimet hetimore, rezulton se vendi i takimit është caktuar për në datën 06.10.2015 ora 06.15 – 06.30, tek shkolla Italiane, 100 m pa arritur tek autogrila, tek fusha, në Fier.

Gjithashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor, rezultoi se shtetasi Gazmir Nelollari, më datë 06.10.2015 në orën 04.10 të mëngjesit, del nga banesa e tij, me mjetin tip Ford, me ngjyrë gri, me targa AA 841 CD, dhe bashkë me drejtuesin e këtij mjeti nisen për në qytetin e Fierit.

Shtetasi Gazmir Nelollari njofton prokurorin, rreth ores 6:25, si kishte mbërritur tek shkolla, dhe më pas takohet me të. Pasi bisedojnë për pak minuta, së bashku futen në automjetin që drejtonte Gazmir Nelollari dhe lëvizin në drejtim të doganës Fier, kthehen djathtas, në rrugën “Andon Xoxa”. Pas rreth dy minutash, Gazmir Nelollari, kthehet i vetëm tek karburanti dhe merr shoqëruesin e tij, dhe largohen së bashku (nje fakt i tillë rezulton nga raporti përmbledhës nr. 1940 prot. datë 13.10.2015, dhe nga traskriptimi i përgjimeve të bisedave telefonike të datës 06.10.2015).


Shtetasi Gazmir Nelollari, njofton menjëherë Arjan Xhemalin, se porosia që kishin folur ishte kryer, por që nuk duhet ti tregonte avokatit për një fakt të tillë, dhe se tani çdo gjë ishte e rregulluar (kjo sipas traskriptimit të datës 06.10.2015).

Shtetasi Gazmir Nelollari, i raporton edhe Elton Xhemalit, se tashmë i ka mbaruar të gjitha detyrimet, të gjitha problemet, duke e sqaruar se në orën 06.15, të datës 06.10.2015, ka qenë tek vendi dhe i është thënë nga prokurori të ikë pa merak.

Më datë 07.10.2015, Arjan Xhemali rreth orës 12.15, hyn sëbashku me dy persona të tjerë në ambjentet e brendshme të gjykatës, pasi rreth orës 13.00, zhvillohej gjykimi në ngarkim të shtetasit Elton Xhemali.

Gjithashtu ka rezultuar se ndër personat që janë afruar në orën 12.55, të datës 07.10.2015, pranë sallës nr. 5, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku do të zhvillohej gjykimi në ngarkim të shtetasit Elton Xhemali, përveç gjyqtarëve dhe avokatit, ka qenë edhe prokurori Petrit Vukaj (i cili një ditë më parë, në orët e para të mëngjesit, ishte takuar me shtetasin Gazmir Nelollarin).

Pas përfundimit të gjykimit, të datës 07.10.2015, rreth ores 14.31, shtetasi Elton Xhemali, duke qene se nuk e ka kuptuar ecurine e gjykimit në ngarkim të tij, për këtë shkak, vëllai i tij Arjan Xhemali e ka sqaruar, se



Duke qenë se nuk ishte realizuar “puna”ahtu siç duhej, Elton Xhemali kërkon llogari vazhdimisht Gazmir Nelollarit për të kthyer paratë e dhëna tashmë, ndërsa ky i fundit i premton se më datë 13.10.2015, do të shkojë në Fier, të takojë ata që i kanë detyrime dhe më pas do të shkojë tek Elton Xhemali (sipas transkriptimeve të përgjimeve të datës 12.10.2015).

Më datë 13.10.2015, rreth orës 12.26, Gazmir Nelollari, niset nga qyteti i Tiranës, me automjetin me targa AA 841 CD, dhe menjë tjetër person për të shkuar në Fier, ku në orën 17.24, ndalojnë në hyrje të Fierit, tek ura e Sheqit. Personat e tjerë që ishin në makinë zbresin, ndërsa Gazmir Nelollari vazhdon i vetëm në drejtim të unazës së Fierit. Pasi parkon mjetin në hyrje të Qendrës Sociale Italiane, futet në ambientet sportive të këtij kompleksi, ku pas dy minutash vërehet se është i ulur në një stol me prokurorin Petrit Vukaj.

Në një distancë rreth dhjetë metra, qëndronte një person tjetër që kontrollonte kush hynte apo dilte nga kompleksi. Pas pak minutash edhe ky person afrohet tek stoli ku ishte ulur Gazmir Nelollari me prokurorin.

Në orën 17.40, (të datës 13.10.2015), Gazmir Nelollari ndahet nga prokurori Petrit Vukaj, merr në automjet personin që kryente rolin e rojes gjatë takimit të tij me prokurorin, hipin në automjetin që e drejtonte Gazmir Nelollari dhe lëvizin në drejtim të doganës, kthehen djathtas në rrugën Andon Xoxa. Personi zbret, ndërsa Gazmir Nelollari, lëviz në drejtim të urës së Sheqit, merr personat që kishte lënë më parë aty, dhe nisen në drejtim të Tiranës (këto fakte rezultojnë sipas raportit përmbledhës nr. 1940/6 prot datë 16.10.2015).

Pasi ishte vënë në dijeni të veprimeve të mësipërme, Elton Xhemali, vazhdon t'i kërkojë të vëllait, Arjan Xhemali, që të kontaktojë me Gazmir Nelollarin, dhe të kthente pas porosinë (kjo sipas transkriptimit të datës 16.10.2015), ku pasi kontakton vetë me Gazmir Nelollarin, më datë 16.10.2015, ky i fundit i bën të ditur se po takohet me njerëzit, ka shkuar dhe është kthyer gjatë gjithë natës, ndërsa Elton Xhemali, i përgjigjet se trupi gjykues nuk i ka marrë lekët, se puna e tij kishte ngelur pa u kryer.

Gjithashtu nga hetimet, ka rezultuar se me datë 27.10.2015, Arjan Xhemali, ka kontaktuar me shtetasin Gazmir Nelollarin, ku ky i fundit, i ka thënë se do të shkonte në Vlorë dhe atje do mbyllet muhabeti.

Nga ana e organit të akuzës, pas arrestimit, me datë 08.11.2015, ka marrë në pyetje personin nën hetim Arjan Xhemali, i cili ka konfirmuar edhe një herë rrethanat e faktit si më lartë, personat e përfshirë si dhe veprimet e kryera nga secilit prej tyre (deklarime të cilat i konfirmoj edhe në seancën